



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 115/Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2023

VENDIM
Nr. 468, datë 24.08.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të “Gërmimit arkeologjik të shpëtimit të nekropolit tumular në Himarë” me aplikues dhe zhvillues DRTK Vlorë;
2. Të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit nga DRTK Vlorë në bashkëpunim me DSHANË;
3. Rezultatet e gërmimit arkeologjik të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM-së;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Klesta QIRICI

Klesta
Qirici

Digitally signed by
Klesta Qirici
Date: 2023.08.25
13:33:51 +02'00'

Elva
Margariti

Digitally signed by Elva
Margariti
Date: 2023.08.25
13:41:49 +02'00'